




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>ZD./DPK</u>	Nr. Prot. Br Prot. <u>01-2764/15</u> Prot No. <u>01-2764/15</u>
Nr. I faq. Nr. I stranica <u>3</u> Pages <u>3</u>	Datum Date <u>15.09.2015</u>



DATE/A:	15/09/2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP – 03-03/2572/15
PËR/ZA/TO:	z.Behxhet RRUQIQI Shef Divizioni - Prokurimet Qendrore - Agjencia Qendrore e Prokurimit
CC:	z. Mursel RRACI Drejtore Ekzekutiv - Agjencia Qendrore e Prokurimit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtore i Agjencise kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Furnizim me Karburante"

I nderuar z. RRUQIQI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin: "Furnizim me karburante" me numër prokurimi: AQP-AK/14/001/111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin: "Furnizim me Karburante" me numër prokurimi: AQP-AK/14/001/111, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Agjencia Qendrore e Prokurimit, bazuar në mandatin që ka nga Ligji i prokurimit publik Nr.04/L-042 dhe UA - 02/2015 të miratuar me Vendimin e Qeverisë nr.02/13 të datës 12/02/2015, autorizohet për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik. Me këtë rast, AQP-ja publikon ngjarjet kryesore, dokumentet, veprimet e planifikuara dhe të kompletuara të prokurimit publik qendror, regjistrin e autoriteteve kontraktuese palë të prokurimit publik qendror të përbashkëta, shpalos të dhënat e tyre të planeve të prokurimit, dhe siguron raportin e performancës së kontratave qendrore publik. Në UA - 02/2015, Shtojca Nr. 1 - Lista e artikujve për përdorim të përbashkët, në mes tjerash janë edhe derivatet e lëngshme të cilat mund të prokurohen në Agjencinë Qendrore të Prokurimit për autoritetet tjera kontraktuese.

Autoriteti Kontraktues, Agjencia Qendrore e Prokurimit, më datë 07/04/2015 ka bërë publikimin “Njoftim për Kontratë” në KRPP me të cilin njoftim fillohet procedura e furnizimit me karburante për 80 Autoritete Kontraktuese. Procesi ishte zvarritur pas ankesave në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe Autoriteti Kontraktues, Agjencia Qendrore e Prokurimit detyrohet që më datë 10/08/2015 të bëjë vazhdim afati dhe si datë e hapjes caktohet 21/08/2015.

Agjencia Kundër Korrupsion, përmes “Njoftim për Vëzhgim” të datës 25/08/2015 ka njoftuar Agjencinë Qendrore të Prokurimit se do të jetë pjesë e monitorimit të aktivitetit të prokurimit “Furnizim me Karburante” duke dërguar përfaqësuesit e sajë në mbledhjet e komisionit vlerësues.

Pas monitorimit të punës në komisionin vlerësues, Agjencia Kundër Korrupsion konstaton se Dosjen e kanë tërhequr tetë Operator Ekonomik ndërsa Autoriteti Kontraktues ka pranuar katër oferta. Tre nga ofertat ishin si operator individual ndërsa njëra ofertë Grup Operatorësh. Nga katër ofertuesit që kishin paraqitur ofertën e tyre në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, dy ishin eliminuar si të pa përgjegjshëm, ndërsa dy janë cilësuar si të përgjegjshëm.

Në Dosjen e Tenderit të këtij aktiviteti, në Aneks 9 LOKACIONET E PIKAVE TE KARBURANTIT, në pikën 4, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar: *“Largësia maksimale e pikave të karburantit që Operatori Ekonomik ka në pronësi apo të marruna me qira mundë të jetë deri në 10 km nga qendra e qytetit. Për pikat e karburantit që nënkontraktohen, largësia maksimale mundë të jetë deri në 5 Km nga qendra e qytetit”*. Me këtë kriter, Autoriteti Kontraktues ka synuar që të i mundësoj autoriteteve tjera kontraktuese një qasje më të lehtë tek furnizuesit potencial. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues përveç distancës së pikave të karburantit me qendrat e qyteteve përkatëse, ka kërkuar që këto pika të jenë të pajisura edhe me licencë për shitje me pakicë. Për qytetin e Novobërdës ky kriter doli të jetë i pamundur. Sipas një interpretimi të marrë me shkrim nga Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, vetëm dy pika karburanti janë të licencuara në këtë komunë, si të tilla që të dyja janë jashtë perimetrit të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Komisioni vlerësues pasi ka marrë sqarim nga Operatorët Ekonomik për distancën e pikave të karburantit me qendrat e qyteteve, si dhe interpretimin me shkrim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për pikat e licencuara, ka konstatuar se asnjë pikë e karburantit e licencuar në Novobërdë nuk gjendet në perimetrin e kërkuar në dosjen e tenderit. Pra, ky kriter është teknikisht i pamundur të realizohet dhe si të tillë komisioni vlerësues e ka konsideruar si devijim të vogël dhe operatorët ekonomik janë konsideruar si të përgjegjshëm në këtë pikë. Duke pasur parasysh që në këtë aktivitet prokurimi janë kërkuar pika karburanti për 37 qytete të Kosovës dhe vetëm në 1 nga 37 është paraqitur ky problem i pa evitueshëm, Agjencia konsideron si të drejtë rekomandimin e komisionit vlerësues.

Agjencia Kundër Korrupsion konstaton se procesi për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Karburante” me numër prokurimi: AQP-AK/14/001/111 i iniciuar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit deri më tani ka qenë proces në përputhje me Ligjin e Prokurimit dhe në përputhje të plotë me mandatin e Ministrisë së Financave, gjegjësisht Agjencisë Qendrore të Prokurimit

Agjencia Kundër Korrupsion, me anë të këtij Opinioni rekomandon Autoritetin Kontraktues që në vazhdoj me procedurat tutje në pajtim me ligjin e Prokurimit Publik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !